



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic Of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

1	Data	10.07.18	Vendi	KAÇANIK
Nr. 010	Nazari	Shitja		
01	370/01-21870 -1			

KONTRATË PUNE

Komuna e Kaçanikut, përfaqësuar nga Shefket Koxha, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

"Eurotrans" shpk me NRB 600900999 te cilen e përfaqson Jetmir Deda nga f. Doganaj (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

"Asfaltimi i rrugës Gabrric-Duraj " me numër identifikues: 652/18/3321/521 (KA652/18/050/521).

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

"Asfaltimi i rrugës Gabrric-Duraj "

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 36,695.65 €;
(Tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtë qind e dhjetë pesë euro dhe 65/100€).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

2.4 Punëdhënësi pajtohet ta paguaj kontraktuesin dhe atë: Në bazë miratimit të Menagjerit të Projektit vasrësishtë nga ekzekutimi i punëve në teren pas raportit me shkrim nga ana e menagjerit të projektit, ndërsa situacioni perfundimtar paguhet pas raportit perfundimtar të menagjerit të projektit si dhe raport teknik të komisionit për pranim teknik të punëve.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferatë financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (Procesverbal i mbledhjes informative/vizitës së vendit)
- Plani mbi menaxhimin e Kontrates.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Shefket Koxha
Pozita:	Zyrtar përgjegjës prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	10.02.2018
Vula:	



Për Kontraktuesin

Emri:	Jetmir Deda
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	10.02.2018
Vula:	



		Prishtinë
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e Vlerës së Kontratës apo 3,669.57€.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 60 ditë pune.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 12.07.2018 ku i gjith plani dinamik aratohet në ditar ndërtimor.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë :
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% përqindjen e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	<i>[Specifikoni nëse një regjister i punës nuk nevojitet].</i>
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është Valmir Krasniqi
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është:
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë nga 10% e vlerës së pagesës e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkaloj 10% e vlerës totale të kontratës origjinale.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 2 ditë ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 365+30 ditë
Pagesa shëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është 10% të

		<i>vleres se kontrates</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<i>[Specifikoni departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim]</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<i>[shëno te dyja]</i> a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>gjykatën kompetent</i> në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]</i>.